



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:236271
Datë: 18.01.2024
Numri i dokumentit: 05208319

AC-I-23-0067

Në ankesën e

Paditësi

F I, nga fshati M e e, Fushë Kosovë, të cilin e përfaqëson **G A**, avokat, Prishtinë.

Kundër

E paditura/Ankuesja

NSH.New C0 "Grand Hotel SH.P.K", (në likuidim) të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1271 të datës 20 janar 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 janar 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditurës refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1271 të datës 20 janar 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Reathanat procedurale dhe faktike

Me datë 06 korrik 2015, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN173-0226, të datës 24 qershor 2015, me të cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit e datës 18 mars 2015 për pagesën e pagave të pa paguara në shumë prej 2,271.72 euro, nga NSH "New Co Grand Hotel", Prishtinë për periudhën e pa specifikuar, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së bashkuar.

Paditësi në ankesë e precizon periudhën duke i kërkuar pagat e pa paguara prej muajt dhjetor 2011 e deri në gusht 2012, në shumë prej 2,271.72 euro. Paditësi me ankesë e kundërshton vendimin e ankimuar duke pohuar se nuk qëndron konstatimi se kërkesa është parashkruar. Ai pohon se kërkesat në bazë të nenit 371 të LMD-së parashkruhen në afatin prej pesë viteve, ndërsa natyra e kërkesës që ka të bëjë me ushqimin në bazë të nenit 373.3 të LMD-së nuk parashkruhet. Tutje paditësi në ankesë pohon se në këtë ndërmarrje ai ka punuar në periudhën e cekur pavarësisht se kush ishte pronari, ndërsa AKP-ja e ka pasë në menagjim këtë ndërmarrje, dhe nuk i ka kryer obligimet ndaj punëtoreve. Tutje ai pohon se me shkresën e AKP-së nr.246 të datës 07.08.2012, janë njoftuar punëtorët se kërkesat për paga në mënyrë meritore do të shqyrtohen nga Autoriteti i Likuidimit në procedurën e likuidimit. Bashkë me ankesë paditësi ka dorëzuar Autorizimin e Avokatit, kopjen e letërnjoftimit, vendimin e Autoritetit të Likuidimit, një Listë të pagave të papaguara e nënshkruar por jo e protokoluuar dhe e vulosur, një përgjigje të AKP-së Shoqatës sindikale, një Vendim të Shoqatës sindikale, një Njoftim të Shoqatës sindikale, Njoftimi i AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me 02.02.2015, dhe një Kontratë pune të vitit 2007.

Me datë 29 nëntor 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pohoi se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të paraqesë cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa është parashkruar në kuptim të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, pasi që paditësi nuk ka sjellë ndonjë dëshmi që i ka kërkuar këto paga më parë në ndonjë gjykatë kompetente. Pasi që kërkesa është parashkruar, AKP-

ja pohon se Autoriteti i Likuidimit nuk ka pasur mundësi t'i shqyrtojë meritat e rastit. Nga këto arsye, AKP-ja kërkon që të refuzohet ankesa si e pa bazuar. Bashkë me mbrojtje në ankesë AKP-ja i ka dorëzuar të gjitha provat që i ka dorëzuar paditësi me ankesë.

Me datë 20 janar 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-1271, ankesën e paditësit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar, e ka ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si dhe ka obliguar AKP-në ti paguaj paditësit në emër të pagave të papaguara për periudhën dhjetor 2011-gusht 2012, në shumë prej 2,065.20 euro, të cilat do të paguhen në bazë të nenit 40.1.1.7 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Shkalla e I-rë me pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar e ka refuzuar pjesën e kërkesës përtej shumës së aprovuar. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se kërkesa për pagat e papaguara për periudhën nga dhjetor 2011-gusht 2012 në shumë të përgjithshme 2,065.20 euro nuk është parashkruar siç konstaton në mënyrë të gabuar Autoriteti i Likuidimit, pasi që Shoqata sindikale e punëtorëve të NSH-së me datë 20.02.2012 e kishte paraqitur kërkesën në emër të punëtorëve në AKP, dhe kishte kërkuar pagesën e pagave të papaguara të punëtorëve. Kjo kërkesë e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit të kërkesës dhe nuk mund të konsiderohet se kërkesa është parashkruar. Tutje shkalla e I-rë konstaton se me Përgjigjen e AKP-së të datës 07.08.2012, vërtetohet fakti se AKP-ja ka qenë e njoftuar me situatën e mos pagesës së pagave të punëtorëve të NSH-së, si kundër që me këtë përgjigje punëtorët janë njoftuar se kërkesat e tyre për paga do të shqyrtohen në procedurën e likuidimit. Tutje shkalla e I-rë konstaton se në bazë të Listës së pagave të papaguara, vërtetohet se NSH-ja këtij ankuesi i ka mbetur borxh në periudhën e cekur në shumë prej 2,065.20 euro. Ankuesi po ashtu ka sjellë edhe Njoftimi i AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me 02.02.2015, dhe një Kontratë pune të vitit 2007. Me këto prova vërtetohet se ai ka kryer shërbime pune për NSH-në në periudhën e cekur, andaj është aprovuar shuma në emër të pagave të papaguara prej 2,065.20 euro që do të paguhet në bazë të nenit 40.1.1.7 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Shkalla e I-rë ka konstatuar se për pjesën e kërkesës për tej shumës së aprovuar, kjo pjesë e kërkesës është refuzuar, pasi që paditësi nuk ka sjellë prova. Andaj nga këto arsye është aprovuar pjesërisht ankesa e paditësit dhe është ndryshuar Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 06 shkurt 2023, AKP-ja e dorëzon një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-15-1271 të datës 20 janar 2023, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet padia e paditësit si e bazuar dhe të vërtetohet Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se me Aktgjykimin e ankimuar nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike, është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta materiale dhe nuk janë marrë në konsideratë argumentet ligjore të dhëna në vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe në mbrojtjen në ankesë. Tutje AKP-ja pohon se gjetjet faktike të gjykatës janë tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes dhe plotësisht të pa bazuara në ndonjë dokument që ekzistojnë në dosje të lëndës. Tutje AKP-ja pohon se Aktgjykimi i ankimuar nuk i plotëson kushtet e përcaktuara nga neni 54 i LDHP-së ,pasi që nuk pasqyron drejtë gjendjen faktike e cila ka rëndësi materiale lidhur me kërkesën. Tutje AKP-ja pohon se neni 40.1.6.2 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së i jep të drejtë dëmshpërblimi vetëm atyre punëtorëve që janë pushuar nga puna si pasoje apo në lidhje me një veprim të ndërmarrë nga AKP-ja, e që në këtë rast paditëses nuk i është pushuar marrëdhënia e punës me veprimin e AKP-së. Andaj paditësi nuk ka të drejtë në pagat e pretenduara ndaj NSH-së. Tutje AKP-ja pohon se gjykata duhet të lëshohet në shqyrtimin e çështjes dhe të marrë në konsideratë argumentet e ngritura të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 05 prill 2023, paditësi e ka pranuar ankesën, por nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 18 mars 2015 ka parashtruar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me të cilën ai ka kërkuar të paguhen pagat e pa paguara për periudhën e pa specifikuar, nga NSH New Co "Grand Hotel" Prishtinë, në shumë prej 2,271.72 euro. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Paditësi në ankesë e ka precizuar periudhën kohore, dhe kërkon paga nga muaji dhjetor 2011 e deri në gusht 2012, në shumë prej 2,271.72 euro. Paditësi e kundërshton konstatimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për paga është parashkruar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit si të bazuar, e ka ndryshuar Aktgjykimin e ankimuar dhe e ka obliguar AKP-në të ia paguaj paditësit pagat e pa paguara për periudhën dhjetor 2011-gusht 2012 në shume prej 2,065.20 euro, duke konstatuar se kërkesa për paga nuk është parashkruar. Pjesën tjetër të kërkesës përtej shumës së aprovuar shkalla e I-rë e refuzon me arsyetimin se paditësi nuk ka sjellë prova për tërë shumën e kërkuar. Kjo pjesë e vendimit nuk do të shqyrtohet nga Kolegji i Apelit, pasi që ndaj pjesës refuzuese të Aktgjykimit nuk ka ankesë.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë ka bashkangjitur: Autorizimin e Avokatit, kopjen e letërnjoftimit, vendimin e Autoritetit të Likuidimit, një Listë të pagave të papaguara e nënshkruar dhe e vulosur, një përgjigje të AKP-së Shoqatës sindikale, një Vendim të Shoqatës sindikale, një Njoftim të Shoqatës sindikale, Njoftimi i AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me 02.02.2015, dhe një Kontratë pune të vitit 2007.

Në bazë të këtyre provave vërtetohet se Shoqata Sindikale e Punëtorëve të NSH-së me datë 24 korrik 2012 e kishte paraqitur një kërkesë në emër të punëtorëve

në AKP, duke kërkuar prej saj që të paguhen pagat e mbetura borxh për periudhën e cekur.

Në bazë të kësaj kërkesë AKP-ja me datë 06 gusht 2012 e kishte paraqitur një përgjigje për shoqatën sindikale të punëtoreve të NSH-së, në të cilën përgjigje AKP-ja i referohet kërkesës të datës 24 korrik 2012 dhe i udhëzon punëtorët që kërkesat për paga do të shqyrtohen në procedurën e likuidimit, pasi që NSH-ja të hyje në likuidim.

Duke u bazuar në këto prova, Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se kërkesa nuk është parashkruar siç pretendon Autoriteti i Likuidimit në vendimin e ankimuar. Tutje Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja në përgjigjen në ankesë nuk e ka kontestuar shprehimisht lartësinë e kërkuar të kompensimit në emër të pagave të pa paguara, andaj duke u bazuar në këtë fakt dhe në listën e pagave të cilën paditësi e ka sjell me ankesë, Shkalla e I-rë e DHPGJS me të drejtë e ka aprovuar pjesërisht shumën e kërkuar prej 2,065.20 euro, në emër të pagave të pa paguara për periudhën e cekur, e cila shumë do të paguhet nga ana e AKP-së, sipas prioritete të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Andaj nga këto arsye ,ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 21 shkurt 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues _____